


KOMUNA E DEÇANIT

Për	Kryetarin e Komunës së Deçanit z.Bashkim Ramosaj
Nga	Drejtori i DBPZHR në Deçan Rifat Stojkaj
Tema	Raporti i punës për periudhën Janar – Dhjetor 2020
Datë	11/12/2020

- PËRMBLEDHJE** - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës dhe aktiviteteve në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Deçanit përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020-të
- AKTIVITETET E PLANIFIKUARA** – Listimi i aktiviteteve që janë planifikuar për periudhën vjetore janar – dhjetor 2020:
 - Ndarja e mjeteve të punës për 25 fermer nga Komuna e Deçanit edhe GLV Gjeravica;
 - Themeli i komisionit për ndarjen e mirënjohjeve për fermerët me të mirë për vitin 2019;
 - Ndarja e mirënjohjeve për fermerët më të mirë për vitin 2019;
 - Planifikimi dhe pastrimi i pishave në “Sukën e Baballoqit” nga insekti “Tenja Procesionare”;
 - Marrja e vendimit për dhënien në shfrytëzim dhe hapjen e Eko Tregut;
 - Subvencionimi i fermerëve me material fidanor (gështenje) në bashkëpunim me CVNP;
 - Organizimi i takimeve dhe seminareve të ndryshëm me fermer;
 - Hapja e kanaleve të ujitjes në gjithë territorin e komunës së Deçanit;



- Janë pajisur me NIF mbi 400 fermer për zhvillimin e aktivitetit të tyre bujqësor gjatë pandemisë;
- Është themeluar komision i veçantë për njoftimin e fermerëve për afatin e aplikimit për subvencione dhe grante;
- Është përgatitë raport i veçantë për dëmet e shkaktuara gjatë pandemisë në sektorin e bujqësisë;
- Hapja e afatit për aplikim për subvencione dhe grante(kanë aplikuar gjithsej 723 fermer për pagesa direkte dhe 10 fermer për grante);
- Hapja e sezonës së korrje shirjeve(janë ndihmuar fermerët me derivate);
- Është ngritë komision i veçantë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri;
- Janë vizituar 150-të fermerë të Komunës së Deçanit për të parë nga afër dëmet që u janë shkaktuar nga kushtet atmosferike (breshëri dhe shiu) dhe është hartuar raporti për ministrinë e Bujqësisë në vlera financiare për dëmet që u janë shkaktuar fermerëve(180.000E);
- Është bërë organizimi tradicional i ritit të Qethave në bjeshkën e Pllaqicës së Vokshit;
- Është organizuar panairit i ushqimeve(produkteve) tradicionale;
- Është përgatitë raporti për mbjellat e grurit për këtë vit;
- Janë realizuar mbi 60-të vizita në terren tek fermerët;
- Janë lëshuar 12 leje për prerjen e pyjeve private;
- Janë konfiskuar 10.07 m³ ;
- Janë shqiptuar 5 gjoba

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - themelimi i shoqatës së bletarëve dhe blegtorëve në dakordim me Komunën e Deçanit.

- Themeli i komisionit për njoftimin e fermerëve për procedurat e aplikimit për subvencione dhe grante;
- Përgatitja e stafit për afatin e aplikimeve për subvencione dhe grante;
- Hapja e sezonës së korrje shirjeve;
- Mbajtja e ritit të Qethave
- Mbajtja e panairit të ushqimeve(produkteve) tradicionale;
- Përgatitja e raportit për fillimin e të mbjellave;
- Vizita në terren tek fermerët dhe tek fermerët përfitues të garantëve ;
- Themelimi i shoqatave të bletarëve dhe blegtorëve

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA – Listimi i aktiviteteve të implementuara gjatë periudhës raportuese nga DBPZHR duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër.

- Janë ndarë mjete pune për 25-të fermer nga Komuna e Deçanit dhe GLV – Gjeravica
- Është bërë themelimi i komisionit të veçantë për ndarjen e mirënjohjeve për fermerët më të mirë për vitin 2019;
- Janë ndarë mirënjohje për 15-të fermerët më të mirë për vitin 2019-të;
- Është bërë pastrimi i 20 ha me pishë nga insekti ‘’Tenja Procesionare’’ në ‘’Sukën e Baballoqit’’;
- Është marrë vendimi për dhënien në shfrytëzim të Eko Tregut;
- Janë ndarë 300 fidane(gështenjë) për fermerët Deçanas në bashkëpunim me CVNP-në;
- Janë organizuar mbi 30-të takime dhe seminare të ndryshme me fermerë;
- Janë mirëmbajt dhe hapë 20-të kanale për ujitjen e tokave bujqësore;